



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Veçantë**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.** \_\_\_\_\_ **Prot.** \_\_\_\_\_  
**Nr. Dok.202200368/14**

**Tiranë** \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022

**Lënda:** *Rekomandohet marrja e masave për respektimin e lirisë së tubimit dhe të rregullave të shoqërimit të shtetasve (rasti i aktivistes së shoqërisë civile Gj.B)*

**DREJTORISË VENDORE TË POLICISË**

**Tiranë**

**Për dijeni: DREJTORISË SË PËRERGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT**  
**Tiranë**

*Të nderuar,*

Avokati i Popullit ka ndjekur me vëmendje, në një pozicion dinamik proaktiv, në ushtrim të mandatit të tij kushtetues të gjitha rastet që kanë marrë vëmendje publike e lidhen me ushtrimin dhe respektimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të njeriut. Në veçanti, e drejta e tubimit ka zënë një vend të posaçëm në disa raporte dhe rekomandime të institucionit tonë.

Kështu, institucioni i Avokatit të Popullit, sikurse ka vepruar në të gjitha rastet e ngjashme ka qenë në vijimësi i pranishëm me grupet përkatëse të inspektimit, në cilësinë e ekipeve faktmbledhëse, për të vëzhguar dhe vlerësuar situatën e krijuar, gjatë dhe pas

protestave të qytetarëve të organizuara në muajin mars 2022 si shprehje e pakënaqësive të tyre ndaj rritjes së çmimeve të mallrave të shportës dhe karburantit.

Sikurse jeni në dijeni nga korrespondenca që kemi pasur, institucioni i Avokatit të Popullit ka nisur hetimin administrativ për rastin e bërë publik në media lidhur me arrestimin e aktivistes të shoqërisë civile, Gj.B, gjatë protestës së zhvilluar në datën 10 mars 2022.

Pas shoqërimeve dhe ndalimeve të kryera nga Policia e Shtetit atë mbrëmje është vënë re numër i konsiderueshëm i personave të shoqëruar, ndër të cilët dhe aktivistja B..

Në deklaratimet e saj të dhëna në institucionin e Avokatit të Popullit, Gj.B referon se:

*“Në datë 10 mars rreth orës 20.30 kam qenë në rresht të parë pranë kryqëzimit të rrugës “Myslym Shyri”. Te kordoni i policisë që gjendej aty nuk ka pasur asnjë punonjëse femër, ndërkohë që kishte shumë gra dhe vajza në protestë. Pasi unë i jam drejtuar një punonjësi të veshur civil për trajtimin e grave, ai është afruar së bashku me 5 punonjës burra të Forcave Shqiptonja për të më kapur me forcë. Në momentet e fundit pranë fagonit të policisë janë afruar dy punonjëse femra për të më shoqëruar.”*

Zj.B pretendon se fillimisht ka qenë e shoqëruar në Komisaratin nr.3 të Policisë së bashku me rreth 60 persona të tjerë<sup>1</sup>, ku ka qëndruar në pritje një orë, për t’u shoqëruar më pas në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Në komisariat nuk i është komunikuar arsyeja e shoqërimit.

Pas shoqërimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë është pyetur pas mesnatës (pas orës 00.00), ku i janë komunikuar **akuzat për 4 vepra penale**, ndër të cilat edhe për “organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme” parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal. Ndërkohë kur Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.24, datë 04.05.2021 ka shfuqizuar togfjalëshin “pa marrë më parë lejen nga organi kompetent sipas dispozitave të veçanta” në paragrafin e parë të nenit 262 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, si i papajtueshëm me nenet 17, pika 1 dhe 47 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në vijim të deklaratimeve të saj, aktivistja B është shprehur se oficerja e policisë gjyqësore që e ka marrë në pyetje e ka trajtuar në mënyrë arrogante. Po ashtu, ajo është ankuar për ndalimin e saj me forcë nga punonjësit e Forcave Shqiptonja.

Pas pyetjes, ajo është vendosur në dhomat e sigurisë, ku ka fjetur në një sfungjer për tokë, në kushte çnjerëzore. Ka qëndruar në këto kushte për 60 orë. Me mjekun ka komunikuar të nesërmen dhe ka bërë një gjilpërë voltaren qetësues të dhimbjeve. Në vijim theksoi se

---

<sup>1</sup> Kapacitetet e Komisariatit të Policisë nr.3 janë të pamjaftueshme për një numër kaq të lartë të shoqëruarish, vetëm dy dhoma shoqërimi me përmasa 4x5 dhe 3x3, për maksimumi 10 persona të shoqëruar.

gjatë ditëve të arrestimit, por edhe më pas ajo ndihej e lodhur psikologjikisht nga arrestimi dhe mbajtja në kushte degraduese.

Bazuar në nenin 63/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë “*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*” si dhe në bazë të nenit 19 gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, është kërkuar informacion dhe tërheqje dokumentacioni në disa institucione.

Në përgjigje të çështjeve të ngritura nga ana jonë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr.2636/1 prot., datë 21.04.2022 sqaron si vijon:

Shtetasja Gj.B e datëlindjes 04.02.1994, banuese në rrugën “Ali Demi”, Tiranë, është shoqëruar në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.3, Tiranë më datën 10.03.2022, rreth orës 20.30 në kryqëzimin e rrugës “Myslym Shyri” (në afërsi të Gjykatës së Lartë) nga shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja” të DVP Tiranë dhe përkatësisht nga punonjëset e policisë inspektor Denisa Hima dhe inspektor Nertila Koka.

Arsyeja e shoqërimit ka qenë për pjesëmarrje në tubime/manifestime të paligjshme, bllokim të rrugëve duke penguar qarkullimin e mjeteve rrugore dhe përdoruesve të tjerë të rrugës dhe mosbindje ndaj urdhrave të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Fillimisht kjo shtetase është akomoduar dhe mbajtur në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.3 (në ambientin/zyrën e punës të ndihmës specialistëve të policimit në komunitet, në katin e parë të godinës) me mbikëqyrjen dhe prezencën e punonjësve ku janë kryer veprimet procedurale, duke bërë arrestimin në flagrancë të saj.

Gjatë qëndrimit në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.3 dhe në DVP Tiranë kjo shtetase nuk ka paraqitur asnjë ankesë apo kërkesë lidhur me gjendjen shëndetësore dhe qëndrimin, veprimet e punonjësve të policisë.

Kësaj shtetaseje dhe gjithë personave të tjerë të shoqëruar dhe arrestuar gjatë dhe pas protestës së zhvilluar në datën 10.03.2022 në qytetin e Tiranës, u janë garantuar të gjitha të drejtat që iu njej ligji, si:

- U janë bërë të ditura të drejtat që kanë në këtë fazë të procedimit penal, duke u dhënë një kopje të formularit të të drejtave për të arrestuarit/ndaluarit;
- Sigurimi i mbrojtjes me avokat (e arrestuara në fjalë ka zgjedhur mbrojtësin Redon Meksi);
- Është kryer vizitë/kontrolli mjekësor pas arrestimit/ndalimit nga mjeku i DVP Tiranë brenda afateve të përcaktuara.

Materialet për veprimet procedurale të kryera nga policia gjyqësore janë referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda afateve të përcaktuara.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në seancën gjyqësore të datës 13.03.2022 ka shqyrtuar dhe vlerësuar masat e sigurisë për 9 (nëntë) të arrestuar/ndaluar dhe në përfundim ka vendosur vlerësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të personave në hetim dhe ka caktuar si masë të sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” (ku përfshihet dhe shtetasja Gj.B).

Për rastin në fjalë nga ana e strukturave të DVP Tiranë dhe Drejtorisë së Standardeve Profesionale në DPPSH nuk është regjistruar proces hetimor disiplinor ndaj punonjësve të policisë.

Nëpërmjet shkresës nr.2060/1, datë 13.04.2022 të Komisarariatit të Policisë nr.3 ku është mbajtur fillimisht shtetasja Gj.B, referohet se arrestimi i shtetases Gj.B është bërë, pasi ajo ka konsumuar elementet e **katër veprave penale**, “organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”, “prishje e qetësisë publike”, “pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit” , “kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga nenet 262, 274, 293 dhe 236 të Kodit Penal.

Arrestimi i kësaj shtetaseje është vlerësuar si i ligjshëm nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Dokumentacioni i kërkuar nga ana juaj është referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr.1934/K, datë 11.03.2022.

Ndërsa me shkresën nr.686/1, datë 19.04.2022 të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore sqarohet si më poshtë:

Më datë 10.03.2022 ora 20.35 shtetasja Gj.B është shoqëruar në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.3, nga shërbimet e seksionit të forcave të posaçme, “Skuadra Shqiponja”, si e dyshuar për kryerjen e një vepre penale, konkretisht për “bllokim rruge”, “mosbindje ndaj urdhrit të policisë” dhe “prishje të rendit dhe qetësisë publike”.

Shoqërimi është bërë në përputhje me nenin 109/1 të ligjit nr.108/2014 “Për policinë e shtetit”, i ndryshuar dhe Procedurës standarde nr.938, datë 24.07.2019 “*Rregullat teknike të shoqërimit të shtetasve në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

Në vijim janë kryer veprime procedurale për arrestimin në flagrancë të kësaj shtetaseje, për kryerjen e veprave penale të “organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”, “prishja e qetësisë publike”, “pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit”, “kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar përkatësisht nga nenet 262, 274, 293, 236 dhe 25 të Kodit Penal.

Në bazë të nenit 255 të Kodit të Procedurës Penale, shtetasja ka ushtruar të drejtën për t’u mbrojtur nga një avokat të zgjedhur prej saj, konkretisht av.Redon Mexsi, sikundër ka

patur në dispozicion një kopje të listës së të drejtave, e cila është nënshkruar nga ana e saj, në praninë e avokatit<sup>2</sup>.

Pranimi i shtetasës në ambientet e dhomave të sigurisë, në DPV, Tiranë është bërë pas kryerjes së gjithë procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhje e kërkesë/ankesave të tyre”, të miratuara me urdhrin nr.925, datë 18.07.2019.

Në zbatim të këtyre procedurave, jo më vonë se 12 orë nga arrestimi i saj, shtetasës i është kryer kontrolli mjekësor.

Me shkresën nr.1934/k prot., datë 11.03.2022, materialet procedurale mbi arrestimin dhe procedimin në gjendje të lirë për disa shtetas, përfshirë shtetasen Gj.B, i janë dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor me shkurtim vendimi nr.614, datë 12.03.2022 ka vleftësuar si të ligjshëm arrestimin në flagrancë të personit nën hetim Gj.B, sa i takon vetëm dyshimit për kryerjen e veprës penale të “pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit”, parashikuar nga neni 293 i Kodit Penal, duke caktuar ndaj saj masën e sigurimit personal “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

Lidhur me kushtet e ambienteve të dhomave të sigurisë, kjo është një problematikë e shumë trajtuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore. Nga kjo agjenci janë kryer inspektime në të gjitha komisariatet dhe drejtoritë vendore të policisë në qarqe dhe në përfundim të këtij inspektimi i kemi rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit përmirësimin e kushteve në dhomat e sigurisë sipas standardeve të kërkuara nga Bashkimi European.

Sa i përket kërkesës tuaj, në lidhje me hetimin e veprimtarisë së strukturave të Policisë së Shtetit, në lidhje me tubimet e zhvilluara, ju bëjmë me dije se me urdher nr.585, datë 28.03.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, është ngritur grup pune *“Për inspektimin e veprimtarisë së strukturave të Policisë së Shtetit të angazhuara për sigurimin e rendit dhe qetësisë publike, në lidhje me tubimet e zhvilluara”*.

Në kuadër të hetimit administrativ, iu drejtuam edhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë që me shkresën nr.4359/1 prot., datë 20.04.2022 na informoi se:

“Shtetasja Gj.B është shoqëruar në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.3, më datë 10.03.2022, ora 20.30 nga punonjësit e policisë të forcës së Posaçme “Shqiponja”, pasi ka marrë pjesë në protestë të kryqëzimi i rrugës “Myslym Shyri”, me rrugën “Ibrahim

---

<sup>2</sup> Sa më sipër tregon se karta e të drejtave është dhënë në momentin e komunikimit të arrestimit në flagrancë në prani të Av. dhe jo në çastin e hyrjes në Komisariatin e Policisë nr.3 ku duhej të jepej sipas standardit.

Rrugova”, të Gjykata e Lartë duke bllokuar rrugën, duke penguar qarkullimin e mjeteve, për mosbindje ndaj urdhrat të punonjësit të policisë si dhe për prishje të rendit publik.

Shtetasja është akomoduar në katin e parë, te klasa e punës së specialistëve të policisë së zonës të Komisarariatit të Policisë nr.3, nën monitorimin e punonjëses së policisë femër, pasi në ambientet e dhomave ka patur dhe persona të tjerë të shoqëruar ku dhe po kryheshin veprimet nga punonjësit e policisë. Rreth orës 21:40 kjo shtetase, është kaluar në Drejtorinë Vendore të Policisë, për kryerjen e veprimeve procedurale. Gjatë qëndrimit në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.3, shtetasja B nuk ka patur ndonjë ankesë apo pretendim.

Me dërgimin në ambientet e drejtorisë janë kryer veprimet procedurale nga specialistja për hetimin e krimeve të Komisarariatit të Policisë nr.3 ku është bërë edhe arrestimi në flagrancë i shtetases Gj.B, për kryerjen e veprave penale të “organizimi, pjesëmarrja, grumbullimi dhe manifestime të paligjshme”, “prishje e qetësisë publike”, “pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit”, “kundërshtim i punonjësit të rendit publik”, **parashikuar nga nenet 262, 274, 293, 236 dhe 25 i Kodit penal.**

Gjatë qëndrimit në ambientet e DVP Tiranë shtetases Gj.B i janë garantuar të drejtat e njeriut, duke i dhënë për njohje dhe nënshkruar një kopje të formularit “letra e të drejtave të të arrestuarit Gj.B”. Në regjistrin e ankesave të dhomave të sigurisë të Komisarariatit të Policisë nr.3 dhe DVP Tiranë nuk evidentohen ankesa nga kjo shtetase.

Veprimet procedurale të kryera nga policia gjyqësore për shtetasen Gj.B, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka vlerësuar të ligjshme.

Nga përgjigjet e institucioneve, si dhe dokumentacioni i administruar rezulton se:

Sipas procesverbalit për arrestimin në flagrancë të shtetases B të datës **11.03.2022, ora 00.45** *“Arrestimi në flagrancë është kryer pasi u kap gjatë kryerjes së veprave penale organizimi, pjesëmarrja, grumbullimi dhe manifestime të paligjshme, prishje e qetësisë publike, pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit, kundërshtim i punonjësit të rendit publik të kryera në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 262, 274, 293,236 dhe 25 të Kodit Penal, pasi ka marrë pjesë në protestën e zhvilluar në Tiranë ku gjatë kësaj proteste janë bllokuar rrugë të ndryshme në Tiranë në zonën e qendrës, Taivanit, përballë 2 ministrive.”*

Sipas dokumentacionit të administruar, konstatohet se vizita e mjekut është kryer në datë 11.03.2022 ora 11.30 ku shënimi i tij është abrazion i lehtë në pjesën e parakrahut të djathtë.

Sa rezulton nga vendimi gjyqësor, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kërkuar vlerësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetases Gj.B, caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, e dyshuar për kryerjen e

veprave penale të “prishje e qetësisë publike” parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal dhe “pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit” parashikuar nga neni 293 i Kodit Penal.

Në vijim, nga gjykata është vendosur vlerësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë i personit nën hetim Gj.B sa i takon vetëm dyshimit për kryerjen e veprës penale të “pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit” parashikuar nga neni 293 i Kodit Penal dhe caktimi i masës së sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Ndalimi me forcë nga punonjësit e Forcave Shqiptonja pretendohet nga shtetasja se është referuar në polici, gjë e cila nuk rezulton nga përgjigjet e administruara nga ana e organeve kompetente.

Ndër të drejtat e personave të shoqëruar/arrestuar trajtimi në mënyrë humane, njerëzore dhe dinjitoze pa diskriminim race, ngjyre, besimi etnie etj., zë një vend të rëndësishëm. Ky parim duhet të jetë udhërrëfyes i punonjësve të policisë që kanë detyrë shoqërimin dhe ndalimin e shtetasve.

Lidhur me masën e sigurimit, në nenin 229 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohen kriteret e caktimit të masave të sigurimit:

*“1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret.*

*2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal...”*

Kriteret e parashikuara në këtë dispozitë ligjore synojnë proporcionalitetin, përshtatshmërinë specifike të llojit të masës së sigurimit të caktuar me vetë nevojat e sigurimit për atë rast konkret.

Sigurisht është kompetencë e gjykatës që të vlerësojë kërkesat e organit të prokurorisë për caktimin e masave të sigurimit personal, duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat, në favor ose kundër interesit publik, që përlligj një përjashtim nga parimi i respektimit të lirive të individit, duke pasur parasysh prezumimin e pafajësisë dhe paraqitjen e tij në argumentimin e vendimit të dhënë<sup>3</sup>.

Por nga ana tjetër, vërehet se shtetasja B fillimisht është shoqëruar në ambientet e Komisarariatit nr.3 rreth orës 20.30 ku është mbajtur një orë dhe nuk i janë sqaruar arsyet e shoqërimit. Ndërkohë, kur është arrestuar në flagrancë dhe ora e procesverbalit është 00.45. Nga informacionet e dërguara konstatohet se nga ora 20.30 e datës 10.03.2022 deri në 00.45 të datës 11.03.2022 shtetasja B është mbajtur e shoqëruar nga policia, por nuk figuron në asnjë regjistër dhe nuk është mbajtur dokumentacion për këtë fakt.

---

<sup>3</sup> Tomasi kundër Francës, dt. 27.08.1993.

Ndër të tjera, në rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit drejtuar strukturave të policisë kemi theksuar se arrestimi në flagrancë duhet të kryhet nga strukturat e policisë gjyqësore të organit të Prokurorisë dhe nën drejtimin e prokurorit, sipas neneve 24/1, 30/2 dhe 304/2 të Kodit të Procedurës Penale. Në vendosjen e masave të sigurimit personal ndaj autorëve të dyshuar të veprave penale duhen mbajtur gjithmonë në konsideratë kushtet dhe kriteret e caktimit të tyre të parashikuara nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 228, 229 dhe 230 të tij.

Sipas nenit 251 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se: *“Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet.”*

*2. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet ose për një vepër penale të kryer nga pakujdesia, për të cilën ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dhjetë vjet.”*

Në gjendje flagrante gjendet ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.

Ndërkohë shtetasja B është proceduar nga policia gjyqësore për katër vepra penale të parashikuara përkatësisht nga nenet **236, 262, 274, 293, dhe 25 të Kodit Penal të cilat në maksimumin e tyre parashikojnë dënimin deri në dy ose tre vjet, duke shtuar për më tepër edhe bashkëpunimin.**<sup>4</sup>

---

Neni 236

Kundërshtimi që i bëhet punonjësit të policisë së rendit publik, me qëllim për ta penguar atë për të kryer detyrën sipas ligjit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose duke ushtruar dhunë fizike ose më shumë se një herë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.

<sup>4</sup> Neni 262

Organizimi i grumbullimeve dhe i manifestimeve të personave në sheshe dhe vende të kalimit publik, apo kur nga organizatorët shkelen kushtet e parashtruara në kërkesën për dhënie të lejes, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit. Pjesëmarrja në një grumbullim apo manifestim të paligjshëm edhe pas paralajmërimit të bërë për shpërndarje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj. Po kjo vepër, e kryer më shumë se një herë ose kur ka sjellë pasoja të rënda, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 274

Hedhja e gurëve apo sendeve të tjera në banesën e shtetasit, krijimi i zhurmave shqetësuese si, me anë të shkrepses së armëve apo plasjeve të ndryshme, të përdorimit jashtë rregullave të sirenavë të automjeteve, apo çdo lloj tjetër sjelljeje të papëlqyeshme, në rrugë, sheshe e vende publike, që cenojnë dukshëm qetësinë e moralin apo tregon mospërfillje të hapët për mjedisin, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Ushtrimi i veprimtarisë ekonomike që lëshon/gjeneron zhurmë në kundërshtim me ligjin apo në tejkalim të normave të lejuara me ligj, që cenon dukshëm qetësinë në zona të banuara ose në mjedise publike, kur është marrë më parë masa administrative, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 293



Gjithashtu, nëse një person arrestohet në flagrancë apo ndalohet, në procesverbalin përkatës të arrestimit/ndalimit duhet të vihet **çasti, ora, e kapjes së tij në fakt, kur ai është privuar realisht nga liria**. Pra, sapo ai kapet dhe prangoset nga punonjësi i policisë që ka bërë kapjen në flagrancë apo ora kur bëhet ekzekutimi i urdhrin të ndalimit. Duke iu referuar neneve 144, 250 të Kodit të Procedurës Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48 orëve, brenda të cilit prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Nga informacioni i marrë, konstatojmë se nga ana e punonjësve të policisë së shtetit i janë atribuar 4 vepra penale, ndërkohë që në kërkesën e prokurorisë është kërkuar caktimi i një mase më të lehtë sigurimi, ajo e “detyrimit për t’u paraqitur” si e dyshuar për dy vepra penale dhe së fundmi gjykata ka caktuar masën e sigurimit personal detyrim për t’u paraqitur vetëm për dyshimin për një vepër penale.

Standardi i njohjes dhe zbatimit të ligjit nga policia e shtetit është më i lartë se i qytetarëve dhe është e papranueshme demonstrimi i një mosnjohje të zhvillimeve kushtetuese në vendime. Ky nivel njohjeje cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese të qytetarëve, lë shteg për arbitraritet dhe cenon reputacionin dhe besimin e qytetarëve te policia e shtetit.

Sipas Kodit të Procedurës Penale çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. *Arrestimi në burg* mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të të pandehurit.

Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kërkojnë që çdo kufizim i lirisë duhet të jetë përjashtim, objektivisht i justifikuar dhe për një kohëzgjatje jo më shumë se sa është absolutisht i domosdoshëm. Standardet ndërkombëtare inkurajojnë shprehimisht mospërdorimin e masave shtrënguese të kufizimit të lirisë gjatë hetimit dhe gjykimit, deri në dhënien e vendimit.

Kodi i Procedurës Penale të RSH parashikon vendosjen e disa masave paraprake të kufizimit të lirisë, përkatësisht “*arrestimi në flagrancë*” dhe “*ndalimi i të dyshuarit për një krim*”. Këto masa paraprake kanë kohëzgjatje të kufizuar në kohë dhe duhet të ndjekin respektimin e disa kriterëve strikte, si edhe të të drejtave dhe garancive procedurale ndaj

---

Vënia e pengesave ose ndalimi, me çdo mjet e mënyrë, i qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujor e ajror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Neni 25

Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre.

personave që zbatohen, deri sa gjykata të vendosë vleftësimin ose jo të masës së sigurimit personal të kërkuar nga prokuroria. Ndalimi nuk lidhet me flagrancën, por me dyshimin për kryerjen e një krimi dhe rrezikun e ikjes. Kërkesa e prokurorit për vlerësimin e arrestit në flagrancë apo të ndalimit, si masë e ligjshme, dhe për caktimin e masës së sigurimit që vlerësohet e përshtatshme, duhet të jetë e argumentuar.

Gjithashtu, lidhur me mbajtjen e tubuesve, si dhe në veçanti të femrave, në dhomat e sigurisë që kanë kapacitet për një-dy persona, ndërkohë që në to vendosen mbi 6 persona, në kushte degraduese në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, përbën shkelje të të drejtave të njeriut.

Sipas Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës (KPT) në shumë vende të Evropës, problemi i vazhdueshëm i mbipopullimit në burgje, me të gjitha sfidat e lidhura me të, duhet t'i atribuohet në një masë të madhe përqindjes së lartë të popullimit të burgjeve nga të paraburgosurit (të cilët janë personat e ndaluar me urdhër të gjykatës që janë ende në pritje të gjykitimit, ose nuk janë dënuar me një vendim të formës së prerë)<sup>5</sup>.

Brenda zonës së Këshillit të Evropës, shpeshësia dhe kohëzgjatja e paraburgimit duket se ndryshojnë shumë në praktikë nga një vend në tjetrin, me përqindjen e personave të ndaluar në paraburgim në raport me popullatën e përgjithshme të burgjeve që varion nga 8% deri në 70%.<sup>6</sup>

Sipas këndvështrimit të KPT-së, parimi që ndalimi në paraburgim duhet të vendoset vetëm si mjet i fundit nënkupton në radhë të parë që sa më shumë të jetë e mundur duhet të zbatohen masat jo nën ruajtje (pra, jo në paraburgim). Kjo kërkon disponueshmërinë e një game të gjerë masash, si pezullimin e kushtëzuar të paraburgimit, lirimin me kusht, arrest shtëpie, monitorimin elektronik, detyrimin për të përmbushur urdhrat e caktuara, mbikëqyrjen gjyqësore, marrjen e pasaportave etj.<sup>7</sup>

Nga vlerësimi i kushteve materiale të dhomave, ato nuk janë sipas parametrave teknike jetësore të përcaktuar në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Vlen të theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) shprehet se norma minimale e hapësirës për person, në institucione të tilla është 6 m<sup>2</sup>, për dhomat për një person dhe 4 m<sup>2</sup>, kur në to sistemohen më shumë persona (pa llogaritur objektet sanitare)<sup>8</sup>. Sigurimi i

---

<sup>5</sup> Këshilli i Evropës, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit çnjerëzor dhe poshtëruës (KPT), Pjesë nga raporti i 26-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 2017.

<sup>6</sup> Statistikat Vjetore Penale të Këshillit të Evropës, SPACE I – Popullsia në burgje, Anketë 2015, PC-CP (2016) 6, 15 dhjetor 2016, tabelat 4 dhe 5.1. Sipas kësaj ankete, mesatarisht, rreth 25% e të gjithë të burgosurve në zonën e Këshillit të Evropës kanë qenë në paraburgim.

<sup>7</sup> Shih nenet 5(1)(c) dhe 5(3) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe praktikën përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si edhe Dokumentin e Bardhë për Mbipopullimin në Burgje, Komiteti i Problemeve të Krimeve të Këshillit të Evropës (CDPC), PC-CP (2015) 6 rish. 7, paragrafi 62.

<sup>8</sup> Raporti i Përgjithshëm i 25-të mbi aktivitetet e KPT-së (CPT/Inf (2016) 10), paragrafi 84.

hapësirës jetësore në më pak se 4 m<sup>2</sup> rrit ndjeshëm rrezikun e shkeljes së nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>9</sup>.

Avokati i Popullit vlerëson se legjislacioni që mbulon lirinë e tubimit paqësor duhet të jetë i qartë dhe i hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Sipas këtyre të fundit, nuk është e nevojshme që legjislacioni i brendshëm të kërkojë njoftimin paraprak të një tubimi, por njoftimi u mundëson autoriteteve shtetërore të lehtësojnë mbledhjen e protestuesve, si dhe të sigurojnë rendin publik dhe të mbrojnë të drejtat e të tjerëve.

***Liria e tubimit nuk i nënshtrohet asnjë formaliteti miratimi nga organet e policisë***, por për ushtrimin e kësaj të drejte, sipas ligjit nr.8773/2001 “Për tubimet”, kërkohet vetëm bërja e njoftimit në organet e policisë në një kohë të përcaktuar. Fakti që në ligjin nr.8773/2001 përdoret termi “njoftim” dhe jo “kërkesë”, drejtuar organeve të policisë për zhvillimin e tubimit është me rëndësi, pasi garanton ushtrimin e së drejtës së tubimit nga ana e shtetasve. Pra, vendimin për ushtrimin e së drejtës së tubimit e merr vetë subjekti njoftues dhe nuk kërkohet miratimi/leja e organit të policisë.

***Togfjalëshi që përmban neni 262, paragrafi i parë, i Kodit Penal, objekt kërkesë, është i papajtueshëm me nenin 47 të Kushtetutës, si dhe me nenet 11 dhe 18 të KEDNJ-së***, pasi kufizon ushtrimin e së drejtës së tubimit me marrjen e lejes, ndërkohë që leja nuk parashikohet as në Kushtetutë, as në ligjin nr. 8773/2001 “Për tubimet”. Ky togfjalësh jo vetëm është i tejkualuar në kohë, pasi i përket periudhës përpara miratimit të Kushtetutës së vitit 1998, por nuk është përshtatur as me ligjin nr.8773/2001 “Për tubimet”.

Më të drejtë, Gjykata Kushtetuese ka argumentuar se: “GJEDNJ-ja ka pranuar se e drejta e tubimit paqësor e garantuar nga neni 11 i KEDNJ-së është themelore në një shoqëri demokratike, e, për rrjedhojë, nuk duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtuar (shih Kudrevičius dhe të tjerë kundër Lituanisë, 15 tetor 2015, § 91). Kjo e drejtë mbulon si mbledhjet private, ashtu edhe mbledhjet në vende publike, qofshin të palëvizshme ose në formë procesioni. E drejta e tubimit ushtrohet si nga pjesëmarrësit individualë, ashtu edhe nga personat që e organizojnë atë (shih Djavit An kundër Turqisë, 20 shkurt 2003, § 56).

Gjykata Kushtetuese vlerëson se togfjalëshi “pa marrë më parë lejen nga organi kompetent sipas dispozitave të veçanta”, në paragrafin e parë të nenit 262 të KP-së, është i papajtueshëm me nenin 47 të Kushtetutës, është i bazuar dhe ka vendosur pranimin e kërkesës, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit të plotësojë normën ligjore nga data e shpalljes së vendimit të GjK deri në hyrjen në fuqi të tij.

---

<sup>9</sup> Muršić kundër Kroacisë [GC], nr. 7334/13, 20 tetor 2016.

Kështu, aktivistët e shoqërisë civile gëzojnë lirinë/të drejtën për të tubuar/protestuar, duke shfaqur pakënaqësitë e tyre dhe organet kompetente duhet ta garantojnë këtë liri, duke shmangur intimidimin apo frenimin e nismave të tyre.

Për gjithë sa parashtruam më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*:

### **REKOMANDOJMË:**

- Dërgimin për njohje të gjithë drejtorive dhe komisariateve të policisë të vendimit nr.24, datë 04.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese.
- Mbjajtjen në vëmendje të këtij rekomandimi në kryerjen e vlerësimit të punës së punonjësve të policisë që kanë bërë referimet për veprat penale të paparashikuara në ligj.
- Marrjen e masave për respektimin e lirisë së tubimit për aktivistët e shoqërisë civile sipas parimeve demokratike të mbajtjes dhe zhvillimit të tyre.
- Marrjen e masave për respektimin me rigorozitet të parashikimeve të urdhrin nr.894, datë 19.07.2022 *“Procedura standarde e punës për “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e Policisë”* lidhur me respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar dhe mbajtjen e dokumentacionit përkatës.
- Marrjen e masave për respektimin e kushteve për arrestimin në flagrancë të shtetasve sipas kriterëve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, si dhe njëkohësisht duke përcaktuar si orë të arrestimit orën e ndalimit nga punonjësit e policisë.
- Marrjen e masave për analizimin në tërësi të problematikave të evidentuara në këtë rekomandim nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë dhe mospërsëritjen e tyre në të ardhmen.
- Marrjen e masave për mbajtjen në kushte sipas standardeve të përcaktuara në aktet ndërkombëtare dhe ato të brendshme të personave të arrestuar.

- Marrjen e masave për trajnimin e punonjësve të policisë së shtetit në lidhje me policimin e protestave.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**